Nëntor 2026

Të nderuara familje,

Në Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut (NYCPS), besojmë se çdo fëmijë meriton të ndihet i sigurt, i mirëpritur dhe i vlerësuar në shkollë. Shkollat tona janë vende ku të gjithë nxënësit mund të mësojnë dhe të gjejnë mundësi, pavarësisht nga statusi i tyre i imigracionit, vendi i origjinës ose gjuha që flasin në shtëpi.

Në shtator, ju bëra të ditur angazhimin tonë për të mbështetur të gjithë fëmijët dhe familjet, përfshirë komunitetet tona të imigrantëve. Sot, ndërsa masat për zbatimin e ligjeve të imigracionit vazhdojnë të krijojnë pasiguri dhe shqetësim për shumë njujorkezë, dua ta riafirmoj këtë angazhim. **Çdo fëmijë e ka vendin në shkollat tona dhe çdo familje është e rëndësishme për komunitetin tonë shkollor.**

Duam që të gjitha familjet të ndihen të informuara, të përgatitura dhe të mbështetura. Për këtë arsye, pak para fillimit të vitit shkollor, përditësuam protokollet tona për organet jovendore të zbatimit të ligjit. Këto përditësime mbulojnë hyrjen dhe daljen e nxënësve nga shkolla, veprimtaritë jashtë mjediseve të shkollës dhe programet pas mësimit e gjatë fundjavës. *Udhëzuesi shoqërues për të drejtat dhe burimet për familjet e imigrantëve* ofron informacion shtesë për masat e mbrojtjes së nxënësve, procedurat e sigurisë në shkollë, planifikimin për raste urgjente, ndihmën gjuhësore dhe burimet ligjore e komunitare që janë në dispozicion. Për më shumë informacion, familjet mund të vizitojnë edhe schools.nyc.gov/ProjectOpenArms.

NYCPS nuk kërkon të dhëna për statusin e imigracionit të nxënësve ose të familjeve të tyre dhe as nuk e gjurmon këtë status. Ne i mbrojmë të dhënat e nxënësve në përputhje me ligjet federale dhe shtetërore për privatësinë. Gjithashtu, zbatojmë protokolle të rrepta kur u përgjigjemi autoriteteve që zbatojnë ligjet e imigracionit.

Angazhimi ynë ndaj familjeve të imigrantëve është i qartë. Çdo fëmijë është i mirëpritur, çdo familje trajtohet me dinjitet dhe çdo nxënës merr mbështetje. Fëmijët tuaj e kanë vendin në klasat tona. Jemi pranë jush për të mbështetur arsimimin dhe mirëqenien e tyre.

Ju falënderojmë që na besoni arsimimin e fëmijës suaj dhe që jeni anëtarë të çmuar të komuniteteve tona shkollore.

Skanoni kodin QR për të hapur *udhëzuesin mbi të drejtat dhe burimet për familjet e emigrantëve*

Në bashkëpunim,

Kamar H. Samuels
Kancelar (Chancellor)